



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS



DETYRË PROJEKTIMI

(Terma Refence të Përgjithshme)

PËR PROJEKTIMIN E OBJEKTIT: HARTIMI I PLANEVE TE GADISHMERISE SE EMERGJENCAVE TE DIGAVE, HARTIMI I PASHAPORTAVE TE DIGAVE DHE HARTIMI I PROJEKT-PREVENNTIVAVE PER REHABILITIMIN E DIGAVE, BASHKIA DURRËS.

MIRATOHET
ZV.Krytare

Elio JANI

1	HYRJE	3
2	VENDNDODHJA DHE PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM	4
2.1	Vendndodhja e objektit të studimit	4
2.2	Historiku.....	6
2.2.1	Rezervuari Topana.	6
2.2.2	Rezervuari Ishëm/Likmetaj.....	7
2.2.3	Rezervuari Memaj.....	8
2.2.4	Rezervuari Rromanat	8
2.2.5	Rezervuari Spitalle 2.....	9
2.3	Situata Aktuale në Sektor	10
3	OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA	10
3.1	Objektivi i Përgjithshëm.....	10
3.2	Qëllimi i projektit.....	10
4	KËRKESAT E PROJEKTIT	11
5	REALIZIMI I PROJEKTIT	12
6	ORGANIZIMI, PLANI I PUNËS DHE STAFI I KËRKUAR.....	17
6.1	Gjuha e përdorur, komunikimet, raportimet dhe takimet.....	17
6.2	Rekomandime për projektuesin.....	17
6.3	Raportet për dorëzim.....	17
6.3.1	Analiza e detyrës së projektimit (brenda 1 muaji nga fillimi).	18
6.3.2	Raporti i rilevimit topografik, studimin gjeologjik (brenda 2 muajve)	18
6.3.1	Projekt ide paraprake (brenda 4 muajve)	18
6.3.2	Projekt ide përfundimtare (brenda 7 muajve)	18
6.3.3	Projekti zbatimi (brenda 9 muajve).....	19
6.3.4	Hartimi i preventivit përfundimtar (brenda 10 muajve)	19
6.4	Profili i Konsulentit dhe Personeli	20
6.4.1	Liçenca profesionale e konsulentit lidhur me ekzekutimin e shërbimeve, duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:	20
6.4.2	Çertifikatat ISO si me poshte:.....	21
6.4.3	Stafi / Ekipi i Ekspertëve	21
6.4.1	Mjetet dhe paisjet.....	24
7	FONDI LIMIT.	24
8	STANDARDET	24
8.1	Standarde në projektim.....	24
8.1.1	Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik	25
9	MARRJA NË DORËZIM.....	25

1 HYRJE

Bashkia Durrës në kuadër të zhvillit të qytetit dhe përmirësimit të infrastrukturës publike ka përcaktuar në buxhetin e bashkisë për vitin 2023 hartimin e studim projektimit për hartimin e planeve të gadishmërisë së emergjencave të digave, hartimin e pashaportave të digave dhe hartimin e projekt-preventivave për rehabilitimin e digave.

Nëpërmjet këtij projekti kërkon të realizojë hartimi e planeve të gadishmërisë së emergjencave të digave, hartimin e pashaportave të digave dhe hartimin e projekt-preventivave për rehabilitimin e 5 digave të cilat janë në kushte emergjente me qëllim rritjen e sigurisë së digës në bazë të ligjeve Shqiptare dhe kërkesave të Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha.

Në tabelen e mëposhtëm jepet disa të dhëna të digave:

NR	Shfrytëzues i Diges	Emri i Diges	Viti i Komletimit	Lartësia e diges (m)	Gjatesia e kurores se diges (m)	Siperfaqia e ujit ne rezervuar ne (m ²)	Volumi I ujit ne rezervuar ne (m ³)	Qellimi I perdorimit te rezervuarit
1	Bashkia Durres	Topana	1978	24	200	330,000	2,500,000	U/AK
2	Bashkia Durres	Ishem/Likmetaj	1968	17	192	185,000	1,000,000	U
3	Bashkia Durres	Memaj	1981	7	130	25,000	100,000	U
4	Bashkia Durres	Romanat	1976	9	150	30,000	135,000	U
5	Bashkia Durres	Spitall 2	1967	11	230	60,000	550,000	AK

Përfituesi /Autoriteti Kontraktues: **Bashkia Durrës**

2 VENDNDODHJA DHE PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM

2.1 Vendndodhja e objektit të studimit

1. Rezervuari Topana



Rezervuari i Topana, ndodhet në Njësinë Administrative Ishem, Bashkisë Durrës dhe aktualisht sherben per vaditje.

Koordinata N e mesit të kurorës së Digës:

N:4597168.909

Koordinata E e mesit të Kurorës së Digës:

E:379089.952

Sist.Koor. :

UTM WGS84

2. Rezervuari Ishem /Likmetaj



Rezervuari i Ishem, ndodhet në Njësinë Administrative Ishem, Bashkisë Durrës dhe aktualisht sherben per vaditje.

Koordinata N e mesit të kurorës së Digës:

N:4600454.282

Koordinata E e mesit të Kurorës së Digës:

E:381125.276

Sist.Koor. :

UTM WGS84

3. Rezervuari Memaj



Rezervuari i Memaj, ndodhet në Njësinë Administrative Rrashbull, Bashkisë Durrës dhe aktualisht sherben per vaditje.

Koordinata N e mesit të kurorës së Digës:

N:4572219.609

Koordinata E e mesit të Kurorës së Digës:

E:380465.901

Sist.Koor. :

UTM WGS84

4. Rezervuari Romanat



Rezervuari i Romanat ndodhet në Njësinë Administrative Rrashbull, Bashkisë Durrës dhe aktualisht sherben per vaditje.

Koordinata N e mesit të kurorës së Digës:

N:4571755.704

Koordinata E e mesit të Kurorës së Digës:

E:381321.352

Sist.Koor. :

UTM WGS84

5. Rezervuari Spitalle 2



Rezervuari i Spitalle 2 ndodhet në Rajonin 5, Bashkisë Durrës dhe aktualisht sherben per vaditje.

Koordinata N e mesit të kurorës së Digës:

N:4576726.820

Koordinata E e mesit të Kurorës së Digës:

E:369271.394

Sist.Koor. :

UTM WGS84

2.2 Historiku

Bashkia Durrës në territorin e saj ka në përdorim gjithësej 17 diga nga të cilat 9 janë klasifikuar në diga të mëdha dhe 8 janë diga të vogela. Rezervuarët që ndodhen në Bashkinë Durrës janë ndërtuar rreth viteve 1960-1985, me material vendi. Këto rezervuar janë ndërtuar me qëllim për vaditje të tokave bujqësore të zonave ku ndodhen. Me ndryshimet demografike dhe ndryshimi i sistemit disa nga rezervuarët e kanë humbur funksionin për vaditje të tokave bujqësore por janë kthyer në funksion të agroturizmit dhe të peshkimit. Nga vërtetimet e vazhdueshme në trupin e digave ka nevojë të instalohen pajisje monitoruese duke qenë se në bjeftin e poshtëm kemi rritje të qendrave të banuara dhe dëmtimi i tyre mund të jetë me pasoja të rënda në popullatë që banojnë aty.

2.2.1 Rezervuari Topana.

Trupi i digës Rezervuari Topana ndodhet në gjëndje jo të mirë teknike, në pjesën veriore ka një rrëshqitje, drenazhet janë funksionale dhe nuk janë shfaqur problematika. Bazamenti i digës është në gjëndje jo të mirë teknike, skarpatet janë të veshura me gurë dhe shafqen rrëshqitje apo problematika të tjera, kurora e digës në gjëndje të mirë, nuk ka pësuar çedime ndërsa elementët e papërshueshmërisë janë të papërcaktueshëm gjendja e tyre.

Vëllimi i shfrytëzueshëm është rreth 65% të kapacitetit ujorë.

Nënobjekte e digës janë :

- Sistemet e devijimit nuk ka.
- Sistemet e shkarkimit janë: shkarkuesi katastrofik, i cili është i veshur me beton dhe në gjëndje jo të mirë teknike.

- Sistemet e marrjes së ujit ndodh nga kodrinat përreth.
- Sistemet e zbrazjes janë saraçineskat të cilat nuk janë në gjëndje pune.
- Sistemet e furnizimit ndodhin vetëm nga kullimi i kodrinave përreth.
- Godina e shërbimit dhe e ruajtje nuk ekziston një godinë për shërbimin dhe ruajtjen e saj.

Monitorimi i digës bëhet vizualisht nga specialistët e Bashkis në mënyrë periodike çdo muaj për të konstatuar problematikat që mund të ndodhin me kalimin e kohës. Masive rrëshqitëse nuk ka.

Pasaportat e digës mungon, lista dhe skema e sistemeve të monitorimit të instaluara nuk ka. Ekipi i monitorimit nuk ka paisjet e duhura për matje.

Plan të gadishmërisë së emergjencave në rastete e emergjencave civile nuk ka.

Analiza dhe konkluzionet për këtë digë janë: nuk ka kushte të mira teknike dhe mund të rrezikohet siguria e saj. Ka nevojë për ndërhyrje elementet e digës dhe në sistemin e hidraulik që të mund të realizon ujitjen e toka buqesore poshte saj. Diga ka pësuar ulje të vogla, filtrimet janë të vogla të cilat nuk shfaqin rrezikshmëri, ka rrëshqitje sekmentale të skrapatave apo të shpateve të ujëmbledhesave.

2.2.2 Rezervuari Ishëm/Likmetaj.

Trupi i digës Rezervuari Ishëm/Likmetaj nuk ndodhet në gjëndje të mirë teknike, ka rrëshqitje zonale, drenazhet kanë dëmtime dhe janë shfaqur problematika në filtrime. Bazamenti i digës është në gjëndje të mirë teknike, skarpatet janë të veshura me bimesi të endur dhe ka rrëshqitje apo problematika të tjera, kurora e digës nuk është në gjëndje të mirë, ka pësuar çedime në disa sekunde ndërsa elementët e papërshueshmërisë janë të papërcaktueshëm gjendja e tyre.

Vëllimi i shfrytëzueshëm është rreth 75% të kapacitetit ujorë.

Nënobjekte e digës janë :

- Sistemet e devijimit nuk ka.
- Sistemet e shkarkimit janë: shkarkuesi katastrofik, i cili është i veshur me beton dhe në gjëndje të mirë teknike.
- Sistemet e marrjes së ujit ndodh nga kodrinat përreth.
- Sistemet e zbrazjes, saraçineskat duhet të zëvendësohen.
- Sistemet e furnizimit ndodhin vetëm nga kullimi i kodrinave përreth.
- Godina e shërbimit dhe e ruajtje nuk ekziston një godinë për shërbimin dhe ruajtjen e saj.

Monitorimi i digës bëhet vizualisht nga specialistët e Bashkis në mënyrë periodike çdo muaj për të konstatuar problematikat që mund të ndodhin me kalimin e kohës. Masive rrëshqitëse nuk ka.

Pasaportat e digës mungon, lista dhe skema e sistemeve të monitorimit të instaluara nuk ka. Ekipi i monitorimit nuk ka paisjet e duhura për matje.

Plan të gadishmërisë së emergjencave në rastete e emergjencave civile nuk ka.

Analiza dhe konkluzionet për këtë digë janë: nuk ka kushte të mira teknike dhe rrezikohet qëndrueshmëria dhe siguria e saj. Ka nevojë për ndërhyrje në sistemin e hidraulik që të mund të

realizon ujitjen e toka buqesore poshte saj. Diga ka pësuar ulje, ka filtrime, ka rrëshqitje të skarpatave apo të shpateve të ujëmbledhesave, ka nevojë për saraçineska pasi kanë dalur jashtë funksioni..

2.2.3 Rezervuari Memaj

Trupi i digës së Rezervuari Memaj nuk ndodhet në gjëndje të mire teknike, ka rrëshqitje zonale dhe disa filtrime të vogla. Drenazhet nuk janë funksionale. Bazamanti i digës nuk është në gjëndje të mirë teknike. Skarpatet e jashtme janë të veshura me bimësi të dendur, skarpata e brëndshme është në gjëndje të mirë. Kurora e digës ka pësuar çedime në segmente të ndryshme të saj. Elementët e papërshkueshmërisë janë të papërcaktueshëm.

Vëllimi i shfrytëzueshëm është rreth 70% të kapacitetit ujqorë.

Nënobjekte të digës janë :

- Sistemet e devijimit nuk ka.
- Sistemet e shkarkimit janë: shkarkuesi katastrofik i cili nuk është në gjëndje të mirë teknike. Sistemet e marrjes së ujit janë nga kodrinat përreth.
- Sistemet e zbrazjes saraçineska të cilat nuk funksionojnë .
- Sistemet e furnizimit ndodhin vetëm nga kullimi I kodrinave përreth.
- Godina e shërbimit dhe e ruajtjes nuk ekziston një godinë për shërbimin dhe ruajtjen e saj.

Monitorimi i digës ndodh në mënyrë periodike çdo muaj për të konstatuar problematikat që mund të ndodhin me kalimin e kohës. Masive rrëshqitëse nuk ka.

Pasaportat e digave, lista dhe skema e sistemeve të monitorimit të instaluara nuk ka.

Plan të gadishmërisë së emergjencave në rastete e emergjencave civile nuk ka.

Analiza dhe konkulzionet për këtë digë janë: rehabilitimi shkarkuesit katastrofik, zhblllokimi i ujëlëshuesit fundor, vendosja e saraçineksave, të cilat e kthejnë rezervuarin në gjëndjen fillestare për të kryer funksionin për të cilin janë ndërtuar si dhe nderhyrje në përmisimin e kusheve dhe elemntëve të digës.

2.2.4 Rezervuari Rromanat

Trupi i digës së Rezervuarit Rromanat nuk ndodhet në gjëndje të mire teknike, ka rrëshqitje zonale dhe disa filtrime të vogla. Drenazhet nuk janë funksionale. Bazamanti i digës nuk është në gjëndje të mirë teknike. Skarpatet e jashtme janë të veshura me bimësi të dendur, skarpata e brëndshme nuk është në gjëndje të mirë. Kurora e digës ka pësuar çedime në segmente të ndryshme të saj.

Elementët e papërshkueshmërisë janë të papërcaktueshëm.

Vëllimi i shfrytëzueshëm është rreth 75% të kapacitetit ujqorë.

Nënobjekte të digës janë :

- Sistemet e devijimit nuk ka.

- Sistemet e shkarkimit janë: shkarkuesi katastrofik i cili nuk është në gjëndje të mirë teknike.
- Sistemet e marrjes së ujit janë nga kodrinat përreth.
- Sistemet e zbrazjes janë saraçineska të cilat nuk funksionojnë.
- Sistemet e furnizimit ndodhin vetëm nga kullimi i kodrinave përreth.
- Godina e shërbimit dhe e ruajtjes nuk ekziston një godinë për shërbimin dhe ruajtjen e saj.

Monitorimi i digës ndodh në mënyrë periodike çdo muaj për të konstatuar problematikat që mund të ndodhin me kalimin e kohës. Masive rrëshqitëse ka në skarpatën e jashtme të saj.

Pasaportat e digave, lista dhe skema e sistemeve të monitorimit të instaluar nuk ka.

Plan të gadishmërisë së emergjencave në rastete e emergjencave civile nuk ka.

Analiza dhe konkluzionet për këtë digë janë: rehabilitimi i të gjithë trupit të digës për të siguruar sigurinë e saj dhe të kryej funksionin për të cilin është ndërtuar dhe i elementëve të digës.

2.2.5 Rezervuari Spitalle 2.

Trupi i digës së Spitalle 2 nuk ndodhet në gjëndje të mirë teknike, ka rrëshqitje zonale dhe filtrime. Drenazhet nuk janë plotësisht funksionale. Bazamenti i digës në gjëndje të mirë teknike. Skarpatet e jashtme janë të veshura me bimësi por në afërsi të tyre ndodhen edhe ndërtime të shumta, skarpata e brëndshme është në gjëndje jo të mirë ku ka disa rrëshqitje. Kurora e digës nuk është në gjëndje të mirë teknike pasi është bërë rrugë kalimi për automjete të ndryshme. Ndërsa elementët e papërshkueshmërisë nuk janë të përcaktueshëm.

Vëllimi i shfrytëzueshëm është rreth 60% të kapacitetit ujorë.

Nënobjekte që janë :

- Sistemet e devijimit nuk ka.
- Sistemet e shkarkimit janë: shkarkuesi katastrofik i cili nuk është në gjëndje të mirë teknike. Sistemet e marrjes së ujit janë nga kodrinat përreth.
- Sistemet e zbrazjes saraçineska në gjëndje të mirë teknike ku është e nevojshme edhe një e dytë në rastet e mosfunksionimit të së parës.
- Sistemet e furnizimit ndodhin vetëm nga kullimi i kodrinave përreth.
- Godina e shërbimit dhe e ruajtjes nuk ekziston një godinë për shërbimin dhe ruajtjen e saj.

Monitorimi i digës ndodh në mënyrë periodike çdo muaj për të konstatuar problematikat që mund të ndodhin me kalimin e kohës. Masive rrëshqitëse nuk ka.

Pasaportat e digave, lista dhe skema e sistemeve të monitorimit të instaluar nuk ka.

Plan të gadishmërisë së emergjencave në rastete e emergjencave civile nuk ka.

Analiza dhe konkluzionet për këtë digë janë: nuk ka kushte të mira teknike dhe rrezikohet qëndrueshmëria dhe siguria e saj, ka nevojë për rehabilitim të shkarkuesit katastrofik, kurorës së digës dhe sistemit të shkarkimit fundor.

2.3 Situata Aktuale në Sektor

Siç u paraqit edhe më lart, problemet që lidhen me moshën e digave konsistojnë në:

- ✓ Kurorat e digave kanë çedime, parapeti është i dëmtuar gjatë gjatësisë së tij.
- ✓ Ka rrëshqitje në pjesën e brendshme të skarpatës, si dhe rrëshqitje që cënon sigurinë e digës në skarpatën e jashtme, ku parametrat teknikë të qëndrueshmërisë, paraqesin problematika për sigurinë e tyre.
- ✓ Pusetat e kontrolleve që lidhen me ujëlëshuesat, janë të dëmtuar ose jashtë funksionit.
- ✓ Saraçineskat e kontrollit që kanë shërbyer për vaditjen, mungojnë (janë jashtë funksionit)
- ✓ Duke patur parasysh rritjen e popullsisë në zonën poshtë digave, shkarkuesit katastrofik sipërfaqësor kanë dëmtime në raste të shirave apo përmbytjeve.

3 OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

3.1 Objektivi i Përgjithshëm

Ky projekt, synon hartimin e pasaportave të digave sipas udhezimit të Komitetit Kombëtar i Digave të Mëdha, analizën e rrisqeve, duke përcaktuar edhe zonën e sigurisë së digave dhe skenarët e evakuimit në funksion të përmirësimit dhe rritjes së performancës së rezervuarëve dhe sigurisë së digave si dhe rehabilitimin e digës, elementëve përbërës të sajë.

3.2 Qëllimi i projektit

- Përgatitja e Dosjes teknike/Pasaporta e Digave bazuar në Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 147, dt.18.03.2004, neni 34, në kërkesat e Udhezimit Nr. 4 të Keshillit të Ministrave, dt.18.07.2003 “Per kërkesat edokumentacionit ligjor dhe teknik qe duhet te permbaje dosja e Digave dhe e dambave” si dhe në Vendimin e KKDM Nr. 2, date 21.09.2020.
- Përgatitjen e Planeve të Gadishmërisë në Rastet e Emergjencave Civile të shkaktuara nga aktiviteti i shfrytëzimit të digave bazuar në:
 - Ligjin Nr. 8681, dt.02.11.2000. "Per projektimin, ndertimin, shfrytëzimin dhe mirembajtjen e digave dhe dambave". Neni 4/d
 - Ligjin Nr. 45/2019. dt. 18.07.2019 *Per Mbrojtjen civile",

- Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 147. dt. 18.03.2004,
 - Udhezimit Nr. 248. dt.28.01.2000 "Per Hartimin e Planit te Alarmit, Evakuimit dhe Ndhimes per Mbrojtjen e Popullates si pasoje e prishjes se Digave he dambave"
- Pergatitja e projektit per nderhyrjet ne trupin e diges dhe ne elementet e saj per te rritur sigurin aty ku eshte e nevojshme.

4 KËRKESAT E PROJEKTIT

Pasaporta e Digave duhet te hartohet bazuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 147, dt.18.03.2004, neni 34, ne kerkesat e Udhezimit Nr. 4 te Keshillit te Ministrave, dt.18.07.2003 "Per kerkesat e dokumentacionit ligjor dhe teknik qe duhet te permbaje dosja e Digave dhe e dambave" si dhe ne Vendimin e KKDM Nr. 2, date 21.09.2020

Per te unifikuar formen e paraqitjes se te dhenave te kerkuara, Dosja Teknike/ Pasaporta e digave do te jepet sipas Formularit Nr. 1 te aprovuar nga KKDM i cili i bashkelidhet ketij Udhezimi. Per digat qe jane ne Shfrytezim prej me se 10 vitesh, Dosja Teknike/ Pasaporta e Digave duhet te permbaje edhe te dhenat ne lidhje me Riparimet apo Permirsimet qe jane kryer se fundmi si dhe te dhenat per matjet Batimetrike te kryera se fundmi sebashku me rezultatet e ketyre matjeve per volumin dhe siperfaqen e ujembledhesit ne nivelin maksimal te tij te shoqeruar me grafiket $V=f(h)$ dhe $S=f(H)$.

Planet e Gadishmerise ne rastet e Emergencave civile te shkaktuara nga aktiviteti i shfrytezimit te digave duhet te hartohen bazuar në:

- Ligjin Nr. 8681,dt,02.11.2000, "Për projektimin, ndertimin, shfrytezimin dhe mirembajtjen e digave dhe dambave". Neni 4/d
- Ligjin Nr. 45/2019, dt. 18.07.2019 "Per Mbrojtjen civile".
- Vendimin e Këshillit te Ministrave Nr. 147, dt. 18.03.2004.
- Udhëzimit Nr. 248, dt.28.01.2000 "Per Hartimin e Planit te Alarmit, Evakuimit dhe Ndhimes per Mbrojtjen e Popullates si pasoje e prishjes se Digave de dambave",

Hartimi i Projekt zbatimit per digat qe do kete nderhyrje emergjente dhe hartimin e preventivit përfundimtar.

Mbas fazës së analizës së detyrës së projektimit, konsulentit do të paraqes projekt zbatimit me të gjithë të dhënat e integruara e të miratuara të projektit, detaje, raporte preventiv dhe të gjithë analizat përkatëse. Mbas kësaj faze projekti duhet të jetë i plotë për zbatim. Lidhur me këtë fakt, projektuesi do të propozoj fazat e realizimit të projektit, ku të dhënat (si fletët e projektit, preventiva, grafiku i punimeve) për çdo fazë, duhet të jenë të konceptuara ose të organizuara, që të lehtësojnë Investitorin në organizimin e zbatimit të projektit me faza.

Për hartimin e preventivit, projektuesi duhet të mbështetet në **VKM NR. 629, datë 15.07.2015** “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Preventivi do të paraqitet sipas formatit të rekomanduar nga Investitori. Konsulenti duhet të paraqesë detyrimisht preventivin përfundimtar të punimeve në përputhje dhe në varësi të projektit të paraqitur. Çdo zë i këtij preventivi duhet të mbështetet në Klasifikimet Ligjore të Kostove dhe Analizat Teknike të Çmimeve nga Manualët Teknike përkatëse, në përputhje me VKM në fuqi. Për zërat që nuk përfshihen në këto Manuale, të bëhet analiza e çmimit bazuar në testimin e tregut.

Kërkesat e përgjithshme të projektimit të digave përmbajnë;

- Qëllimin e ndërtimit.
- Karakteristikat e veçanta dhe të përgjithshme të territorit, në të cilat paraqitet ndikimi nga ndërtimi i objektit.
- Përshkrimin e përgjithshëm të objektit dhe nënobjekteve kryesore dhe justifikimin e variantit të zgjedhur.
- Karakteristikat kryesore të objektit dhe nënobjekteve.
- Vendin, sasinë dhe karakteristikat teknike të materialeve të ndërtimit.
- Detyrat e përkohshme dhe masat paraprake, për kapërcimin e mundshëm të tyre.
- Të dhënat kryesore të objektit, nënobjekteve dhe ujëmbledhësit.

Për realizimin e kërkesave të përgjithshme:

Projektuesi duhet të kryej të gjithë punën në përputhje me standardet e projektimit dhe ndërtimit që janë në fuqi, në Shqipëri. Rritja e sigurisë së veprës është shumë e rëndësishme, pasi pozicioni i saj i shtrirë në një zonë të banuar, e rrit ndjeshëm rrezikshmërinë e saj në raste përmbytjesh të mëdha.

5 REALIZIMI I PROJEKTIT

Realizimi i projektit të veprave inxhinierike grupi kater tarifor do të mbështetet në fazat e **VKM Nr. 354, datë 11.05.2016, Neni 36** si më poshtë:

- **FAZA I Analiza e detyrës së projektimit/termat e referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit.**

Për këtë fazë të punës, Konsulenti duhet të paraqesë:

Analizën e detyrës së projektimit/termave të referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit (format A4); Vëzhgimi dhe mbledhja e dokumenteve fartografike për zonën në të cilën duhet ndërhyrë - (formati A3/A2).

Materiali grafik i përgatitur nga konsulenti duhet të përfshijë:

- Pozicionimin në hartë;
- Përshkrimin e situatës aktuale;
- Verifikimin e projekteve/studimeve të miratuara për zonën objekt studimi etj.
- Përshkrimin e gjendjes së zonës ku do të ndërtohet.

FAZA II Projekt ideja paraprake

1.Projekt idejaparaprake duhet të përmbaje studimet e mëposhtme:

Relacionin teknik, ku të përshkruhen:

- qëllimi i ndërtimit, variantet e hartuara, krahasimi i tyre dhe justifikimi i variantit të zgjedhur, shpjegime mbi përbërësit e varianteve;

Pasaporta e Digave, duhet te jepen:

- Te dhenat te pergjithshme teknike te te gjithë elementeve te Diges te percaktuara ne VKM Nr.147, dt.18.03.2004, Neni 3,
- Te dhenat Teknike ne lidhje me elementet e papershkueshmerise
- Te dhenat ne lidhje me Ujembledhesin e Krijuar nga Ndertimi i Diges (vellimi i perpunimit, vellimi i shfrytezimit dhe vellimi i vdekur) si dhe Masivet rreshqitese (ne se ka) ne brigjet qe errethojne ate
- Vizatimet Teknike te Trupit te Diges dhe Sistemeve te Shkarkimit, Devijimit, Marrjes se Ujit dhe Zbrazjes (te pakten Planimetria dhe Prerjet Terthore e gjatesore te tyre)
- Fotografi te Situates aktuale te Diges dhe elementeve te saj
- Studimet dhe Raportet Mbeshtetese
 - Studimi dhe Raporti Gjeologjik, Gjeoteknik, Gjeologo –Inxhinierik
 - Studimi Sizmik
 - Studimi Hidrologjik
 - Studimi mbi Materialet e Ndertimit
 - Raporti Hidraulik duke perfshire edhe rezultatet e llogaritjeve perkatese
 - Raporti per Instrumentat e kontrollit dhe te matjeve si dhe Sistemet e Monitorimit
 - Cdo document teknik i nevojshem i kerkuar nga KKDM ne perputhje me kerkesat e Udhezimit Nr. 4, Dt. 18.07.2003 “Per kerkesat e dokumentacionit ligjor dhe teknik qe duhet te permbaje dosja e Digave dhe e dambave”.

FAZA III Projekt ideja perfundimtare

1.Projekt ideja perfundimtare duhet të përmbaje studimet e mëposhtme:

Relacionin teknik, ku të përshkruhen:

- parimet kryesore të metodave të llogaritjes së digës dhe nënobjekteve, studimet e kryera për materialet e ndërtimit dhe karrierat që do të përdoren;
- sistemi i telekomunikimit dhe ai radiofonik midis objektit dhe institucioneve të interesuara;
- sistemet e dubluara të furnizimit me energji elektrike të pajisjeve elektrike;
- sistemet e aparaturave të matjes dhe të kontrollit që parashikohet të vendosen në digë dhe nënobjektet e saj;
- rrjeti rrugor i objektit dhe lidhja e tij me atë rajonal për periudhën e ndërtimit dhe shfrytëzimit;
- mënyrat e kontrollit gjatë periudhës së ndërtimit dhe shfrytëzimit;
- studimet e ndryshme që parashikohen për të realizuar projektin e zbatimit;
- ndërtimi i godinës së shërbimit dhe ruajtjes së digës.

Planet e gadishmerise ne rastet e emergencave civile te shkaktuara nga aktiviteti i shfrytezimit te digave duhet te jepen te pakten:

- Pasaporta e Digave sipas Vendimit Nr. 2. dt.21.09.2020 te KKDM
 - Karakteristikat e Vales qe krijohet ne luginen poshte diges/dambes ne rastin kur shkarkohet pruria maksimale ose behet shkarkim i sforcuar (prurje plus zbrazje e detyruar e ujembledhesit) ose ndodh prishja e diges;
 - Hartat e Permbytyjeve ku te jepen siperfaqet dhe zonat e permbytura per seicilin prej 4 skenareve te mundshem:
 - Te dhenat e pergjithshme te Sistemit te Alarmit te instaluar ne zone duke perfshire edhe te dhenat per sistemet dhe pajisiet e instaluara si dhe skemen e sinjalizimit dhe komunikimit ne rastet e ndodhies se ngjarieve ge mund te ndodhin;
 - Planin e Alarmit, te evakuimit dhe te ndihmes per perballimin e pasojave qe vijne si rezultat i situatave te pershkruara ne skenaret perkates.
 - Skemat Organizative per Plain e Veprimet ne rastet e Emergencave civile për 4 skenaret e mundshem:
- **Skenari 0** i cili zbatohet kur Ka prurje te medha me perseritje me shume se 1 here ne 20 jet ose kur ka nje vendim te Ekipit te Emergencave te shfrytezuesit te diges, Ka termet me magnitude mbi 4 shkalle Rihter, Ka veprime sabotazhi me rrezik per sigurine e diges, Ka Situata emergente ne digat e rjedhes se mesiperme, Ka mosfunktionim te sistemeve te shkarkimit,
 - **Skenari 1** i cili zbatohet kur Ka prurje te medha me perseritje me shume se i here ne 100 jet ose kur ka nje vendim te Ekipit te Emergencave te shfrytezuesit te diges ose Agjencise Kombetare te Mbrojtjes Civile (ALMC) prane Ministrise se Mbrojtjes, Ka filtrime shume te medha ne diga, ka

veprime sabotazhi me rrezik per sigurine e diges, ka Situata emergjente ne digat e rrjedhes se mesiperme, ka Rreshqitje te ngadalta te Masiveve jo te gëndrueshme

- **Skenari 2** i cili zbatohet kur Ka prurje te medha me perseritje me shume se 1 here ne 1000 jet ose kur ka nje vendim te vecante te Ekipit te Emergjencave te shfrytezuesit te diges ose te AKMC prane Ministrise se Mbrojtjes. Ka difekte te renda te turbinave qe rrezikojne punen normale te tyre, Ka difekte te renda te sistemeve te shkarkimit ose mosfunksionim i tyre, Ka Difekte dhe demtime te medha qe shogerohen me filtrime apo levizje dherash te kontrollueshme. Ka termete me magnitudo mbi 7 shkalle Rihter, Ka veprime sabotazhi me rrezik te larte per sigurine e diges, Situata emergjente ne digat e rrjedhes se mesiperme. Ka rreshqitje te menjehershme te Masiveve jo te gëndrueshme

- **Skenari 3** i eili batohet kur ka prurjet me te medha te mundshme (PMF) dhe/ose ka nje vendim te vecante te Keshillit te Ministrave ose te AMC prane Ministrise se Mbrojtjes, Ka difekte shume te renda te turbinave qe rrezikojne punen e HEC ne menyre te pashmangshme, Ka difekte shume te renda te sistemeve te shkarkimit qe rrezikojne digen ne menyre te pashmangshme, Ka Difekte he demtime shume te medha dhe te pariparushme te diges qe shogerohen me filtrime apo levizje dherash te pakontrollueshme:

- Te dhena per Planin e Rrugeve Hyrese ne objektet dhe nenobjektet e Diges.
- Burimet e furnizimit me energji elektrike ne rast difektesh dhe ngjarjesh te vecanta.

Materiale grafike, të cilat të përmbajnë:

- planimetritë e bashkëvendosjes së objektit dhe nënobjekteve, prerje gjatësore, tërthore dhe detajet e tyre për të gjitha variantet e studiuara. Materiali të jetë i qartë dhe të krijojë një kuadër të plotë për njohjen e objektit;
- rrjetin rrugor brenda objektit dhe lidhjen e tij me atë rajonal për periudhën e ndërtimit dhe të shfrytëzimit;
- vizatime të vendit të vendosjes së aparaturave matëse e të kontrollit, si dhe tipin e tyre;
- planimetri, prerje gjatësore të kupës së ujëmbledhësit dhe të të gjithë zonës deri ku shtrihet veprimi i objektit, në shkallë të përshtatshme;
- kurbat e vëllimit dhe sipërfaqes së ujëmbledhësit;
- vendet e karierave të materialeve të ndërtimit dhe vendet e depozitimeve të materialeve që dalin nga gërmimet etj.

➤ FAZA V: Projekti zbatimit.

Projekt zbatimi duhet të përmbajë:

- a. Studimin e gjendjes ekzistuese,
- b. Studimin Gjeologjik/Gjeoteknik/Gjeologo-Inxhinierik,
- c. Studimin Hidrologjik/ Hidraulik,
- d. Studimin mbi Materialet e Ndërtimit,
- e. Studimi Sizmik,
- f. Studimin e llogaritjeve të objektit dhe nënobjekteve,
- g. Studime dhe materiale grafike,

Materialet e sipërcituara duhen dorëzuar fizikisht dhe në formatet përkatëse: dwg., word, excel .

Mbas fazës së projekt idesë përfundimtare, konsulenti do të paraqes projekt zbatimit me të gjithë të dhënat e integruara e të miratuara të projektit, detaje, raporte preventiv dhe të gjithë analizat përkatëse. Mbas kësaj faze projekti duhet të jetë i plotë për zbatim. Lidhur me këtë fakt, projektuesi do të propozoj fazat e realizimit të projektit, ku të dhënat (si fletët e projektit, preventiva, grafiku i punimeve) për çdo fazë, duhet të jenë të konceptuara ose të organizuara, që të lehtësojnë Investitorin në organizimin e zbatimit të projektit me faza.

➤ **FAZA VI: Hartimi i preventivit përfundimtar.**

Për hartimin e preventivit, projektuesi duhet të mbështetet në **VKM NR. 629, datë 15.07.2015** “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Preventivi do të paraqitet sipas formatit të rekomanduar nga Investitori. Konsulenti duhet të paraqesë detyrimisht preventivin përfundimtar të punimeve në përputhje dhe në varësi të projektit të paraqitur. Çdo zë i këtij preventivi duhet të mbështetet në Klasifikimet Ligjore të Kostove dhe Analizat Teknike të Çmimeve nga Manualet Teknike përkatëse, në përputhje me VKM në fuqi. Për zërat që nuk përfshihen në këto Manuale, të bëhet analiza e çmimit bazuar në testimin e tregut.

➤ **SHËRBIMET QË I TAKOJNË NËNTOKËS DHE PUNIMEVE NË THEMELE**

Shërbimet, që lidhen me kapacitetin mbajtës të tokës, punime tokësore dhe themele, janë për të regjistruar reagimet midis strukturës së tokës dhe ndërtesave, si dhe mjedisin e saj, për të përcaktuar parametrat kryesorë të strukturës së tokës të nevojshme për llogaritje. Dhënia e zgjidhjeve, drenazhimi, skarparave dhe llogaritje të tjera statike të tokës.

➤ **SHËRBIME TOPOGRAFIKE NË FAZËN E PROJEKTIMIT.**

Shërbimit të rilevimit topografik në fazën e projektimit përfshijnë shërbimet topografike tokësore, fotogrametrike, të veprave inxhinierike. Pas përfundimit të rilevimit topografik, konsulenti do të përgatisë raportin e rilevimit topografik. Raporti duhet të përfshijë të gjitha të dhënat e marra nga terreni, fletët topografike etj, dhe komentet/konkluzionet e ekspertëve.

➤ **SHËRBIMET E STUDIMEVE TË NDIKIMIT NË MJEDIS**

Në lidhje me skenarët e studimit, alternativat teknike të identifikuar do t'i nënshtrohen një vlerësimi paraprak të ndikimit në mjedis, njoftimi për rastet që duhet të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së, rezultatet e të cilit do të kontribuojnë në identifikimin e alternativës së preferuar për zbatimin e projektit. Në veçanti, shqyrtimi paraprak mjedisor do të vlerësojë – në një nivel strategjik – deri në çfarë mase secili prej opsioneve teknike kontribuon/përputhet me kërkesat e legjislacionit Shqipëtarë.

6 ORGANIZIMI, PLANI I PUNËS DHE STAFI I KËRKUAR

6.1 Gjuha e përdorur, komunikimet, raportimet dhe takimet

Gjuha zyrtare e komunikimit dhe raportimit është shqip. Përveçse nëse shprehet ndryshe, raportimi do të jetë në gjuhën angleze, si dhe në takimet / workshopet e mbajtura dhe procesverbalet e takimeve. Një takim fillestar me përfituesit dhe palët e tjera të interesuara, do të mbahet brenda 2 javëve të para nga fillimi i Projektit. Këshillohet që, takimet e rregullta të progresit të mbahen çdo 2 muaj, apo edhe të rastit, nëse është e nevojshme për të zgjidhur çështje specifike. Konsulenti do të mbikqyrret nga Grupi Teknik i Punës i krijuar nga Bashkia Shijak.

Grupi Teknik i Punës (GTP) do të koordinojë të gjitha aktivitetet, duke përfshirë komunikimin ndërmjet Konsulentit dhe Përfituesit si dhe autoriteteve të tjera kompetente. Takime të rregullta mujore do të mbahen me GTP, përfaqësuesit e Përfituesve dhe palët e tjera të interesuara për të raportuar dhe diskutuar mbi progresin e arritur, çështjet kritike dhe të gjitha aspektet e tjera të zbatimit të kësaj detyre. Procesverbali i takimeve do të përgatitet nga Konsulenti dhe do t'u shpërndahet të gjithë pjesmarrësve. Përveç kësaj, mund të kërkohen takime të rastit (ad-hoc), me kërkesë, dhe me pjesmarrjen e Përfituesve dhe përfaqësuesve të GTP-së. Udhëheqësi i Ekipit (menaxheri i skuadrës) i Konsulentit do të udhëheqë detyrën, dhe ai/ajo do të jetë përgjegjës për mbikqyrjen e ekipit të ekspertëve, për sigurimin e progresit të detyrës në përputhje me planin, për koordinimin me palët e interesuara dhe për raportim. Ekipi i ekspertëve do të zhvillojë takime me palët e interesuara siç përcaktohet në planin e punës dhe do t'i mbajë të informuar për progresin e arritur dhe çdo çështje tjetër që ndodh në zbatimin e detyrës.

Ekipi i ekspertëve do të punojë dhe do të koordinojë Termat e Referencës:

6.2 Rekomandime për projektuesin

- a) Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues.
- b) Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Bashkia Durrës, si dhe çdo institucion tjetër që ka lidhje me këtë projekt. Në hartimin e projektit duhet të merren në konsideratë edhe standarde të ndryshme që ka nxjerrë Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha.
- c) Për hartimin e preventivit projektuesi duhet të mbështetet në VKM NR. 629, datë. 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Për secilin zë punimi, i cili nuk është i përfshirë në këtë manual, projektuesi duhet të dorëzojë analizat e çmimeve.

6.3 Raportet për dorëzim

Konsulenti do të ofrojnë sa vijon:

6.3.1 Analiza e detyrës së projektimit (brenda 1 muaji nga fillimi).

Konsulenti do të kryej vizita në terren për mobilizim dhe do të mbajë takime me palët e interesuara. Konsulenti do të përgatisë Raportin Fillestar duke përfshirë planin e veprimit, metodologjinë etj, të cilat, pas rishikimit, do të bëhen një udhëzues për pjesën e mbetur të projektit duke ofruar udhëzimet e nevojshme. Kohëzgjatja e parashikuar e këtij aktiviteti është 1 muaj.

Si pjesë e këtij aktiviteti, Konsulenti do të kryejë detyrat e mëposhtme:

- Takimi prezantues, koordinimi dhe marrëveshja për detyrën me palët kryesore të interesuara.
- Organizimi i fillimit të detyrës (logjistika, përmbajtja, plani i punës, etj.) në mënyrë që aktivitetet pasuese të mund të zhvillohen pa probleme. Mobilizimi i ekipit të ekspertëve.
- Vizita në terren dhe vrojtimi vizual.
- Marrja nga autoritetet dhe rishikimi i studimeve të mëparshme, dokumentacionin e projektimit dhe informacionin bazë për t'u njohur me dokumentacionin në dispozicion.

Kryerja e një vlerësimi të objektivave të Termat e References (ToR) kundrejt dokumentacionit të disponueshëm dhe situatës aktuale në fillim të periudhës së zbatimit dhe sugjerimi mbi ndryshimet e nevojshme, sipas nevojës për qasjen, metodologjinë dhe programin.

Rezultati: Raporti fillestar, i përbërë nga analiza e situatës ekzistuese dhe plani i punës së detyrave, dokumente të shqyrtuara dhe raporte mbi diskutimet e mbajtura me palët kryesore të interesuara, të cilat duhet të nxjerrin në pah dhe të përmbledhin situatën ekzistuese, planin e detajuar të punës, ndarjen e detyrave, kohën, çështjet, si dhe parashikimin e detajuar të përdorimit të burimeve, duke përfshirë draft planin e veprimit të komunikimit (vizibilitetit/dukshmërisë).

6.3.2 Raporti i rilevimit topografik, studimin gjeologjik (brenda 2 muajve)

Konsulenti do të përgatisë raportin e rilevimit topografik. Raporti duhet të përfshijë të gjitha të dhënat e marra nga terreni, fletët topografike etj, dhe komentet/konkluzionet e ekspertëve. Studimi gjeologjik duhet të përfshijë të gjitha të dhënat e marra nga terreni për të gjitha objektet dhe do të hartohet raporti gjeologjik për çdo objekt duke përfshirë dhe konkluzionet e specialisteve të fushës.

6.3.1 Projekt ide paraprake (brenda 4 muajve)

Projekt ideja paraprake do të përmbajë pjesë të rëndësishme të zgjidhje së detyrës së planifikimit në jo me pak së dy variante, përmbajtja e së cilave do të ketë analiza relacione, paraqitje grafike teknike, preventiv paraprak etj. Varianti me treguesit më social - ekonomik dhe teknik, që do të përzgjidhet nga Këshilli Teknik, do të vazhdojë procedurën e hartimit të projekt-idesë përfundimtare.

6.3.2 Projekt ide përfundimtare (brenda 7 muajve)

Në këtë fazë konsulenti do të përgatisë projekt – idenë përfundimtare të ndërhyrjeve, materiale e së cilës duhet të përmbajnë Preventivat finale sipas formatit të miratuar nga Bashkia Tiranë, referuar

VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, analizat teknike të çmimeve, studimet dhe paraqitjet grafike të detajuara sipas zërave të punës.

6.3.3 Projekti zbatimi (brenda 9 muajve)

Dosja e plotë e projektit të zbatimit do të përmbajë:

- a) Raportet teknike (konstruktiv, topografik, gjeologjik, hidroteknik, sizmologjik, gjeologjik, gjeoteknik, arkeologjik, fotovoltaik, hidrologjik dhe mjedisor)
- b) Planvendosjen e objektit
- c) Planimetritë
- d) Rilevimin topografik
- e) Projekti teknik (konstruktiv, topografik, gjeologjik, hidroteknik, sizmologjik, gjeologjik, gjeoteknik, arkeologjik, fotovoltaik, hidrologjik dhe mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin)
- f) Specifikimet teknike për zërat e punimeve që do të kryhen;
- g) Preventivin e punimeve mbështetur në manualin teknike të çmimeve në fuqi;
- h) Grafikon e punimeve të detajuar sipas zërave të punës;
- i) Plan organizimin e punimeve dhe ngritjen e kantierit në funksion të mjeteve, që do të jenë pjesë e realizimit të objektit, mbështetur dhe në grafikon e punimeve;
- j) Raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM);
- k) Liçencë të firmës projektuese, liçencë të ekspertit mjedisor dhe ekstrakt i regjistrit tregtar.
- l) Deklaratat e përgjegjësisë profesionale të stafit pjesmarrës në realizimin e studim-projektimit.

Materialet e sipërcituara duhen dorëzuar fizikisht dhe në formatet përkatëse: dwg, pdf, word, excel.

6.3.4 Hartimi i preventivit përfundimtar (brenda 10 muajve)

Kosto totale do të përcaktohet nga preventivi përfundimtar i objektit, që do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimeve teknike, relacionin, si dhe duke marrë parasysh dhe kërkesat e veçanta të Bashkisë në lidhje me standardet e pranuar.

Për hartimin e preventivit, projektuesi duhet të mbështetet në VKM NR. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Për secilin zë punimi, i cili nuk është i përfshirë në këtë manual, projektuesi duhet të dorëzojë analizat/ofertat përkatëse të çmimeve, të cilat do të bashkëlidhen të detajuara projekt zbatimit, kjo për të siguruar kursimin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve.

Në hartimin e preventivit, veç të tjerave do të mbahen parasysh sa më lart, lidhur me organizmin e zbatimit me faza, çmimet e referencës sipas akteve ligjore në fuqi, dhe llogaritja e preventivit do të

bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve.

Preventivi do të përpilohet sipas formatit/ modelit standard, të rekomanduar nga Bashkia Durrës.

Dorëzimi final, fizik, i projektit të zbatimit, do të konsiderohet ai i cili do të ketë kaluar të gjitha fazat e mësipërme, sipas afateve përkatëse.

I gjithë dokumentacioni do të paraqitet në 3 (tre) kopje , në format soft copy dhe hard copy dhe 1 (nje) kopje në CD.

6.4 Profili i Konsulentit dhe Personeli

6.4.1 Liçenca profesionale e konsulentit lidhur me ekzekutimin e shërbimeve, duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

2. PROJEKTUES ARKITEKT

d- Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

a) Projektim objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

c) 1. Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme – metalike – 2. troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët.

d) Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike;

4. PROJEKTUES INSTALATOR

c) Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale;

d) Projektim të sistemeve komplekse të telekomunikacionit;

f) Projektim të sistemeve kundra zjarrit.;

g) Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa;

i) Projektimi i ndricimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndricimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve, etj.;

j) Projektim të rrjeteve të telefonise, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit, etj., për objektet civile dhe industriale.

5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

a) Projektim diga të mëdha

b) Projektim furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.

d) Projektim vepra ujitje-kullimi-impianete vaditëse-diga të vogla-damba, sifona, kaskada, kapërdredhës, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino

f) Projektim vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi, shkarkues të ujërave të tepërta, vepra të marrjes së ujit nga rezervuarët, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë dhe marrje e ujit me puse

6. PROJEKTUES RRUGË-HEKURUDHA

a) Projektim rrugë lokale, rruge urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore

7. PROJEKTIM URA DHE VEPRA ARTI

a) Projektim ura dhe vepra arti të vogla deri në 10 m

8. PROJEKTUES GJEODET

- a) Rilevime inxhinierike
- c) Sistemet GIS
- e) Projektim fotogrametrik dhe hartografik

9. STUDIM GJEOLOGO INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

- a) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.
- d) Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qendrueshmeri të ulët.
- e) Studime e projektme hidrogjeologjike

10. PROJEKTIMI I IMPIANTËVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

- e) Projektim kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.

11. PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR

- a) Projektim sinjalistike jondricuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime
- d) Projektim sinjalistike ndricuese në infrastrukture.

12. STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE

- a) Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për klasifikimin gjeosizmik të trojeve.
- c) Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte etj.
- e) Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për troje e shpate me qendrueshmëri të ulët dhe për troje ndërtimore të shkriфта me mundësi lëngëzimi.

6.4.2 Çertifikatat ISO si me poshte:

- a) ISO 9001: 2015, Per menaxhimin e cilesise/ekujvalente;
- b) ISO 14001: 2015, Per menaxhimin e cilesise se mjedisit;
- c) ISO 50001-2018, Sistemi i Menaxhimit të Energjisë;

6.4.3 Staf / Ekipi i Ekspertëve

Konsulenti duhet të sigurojë stafin e duhur (në lidhje me ekspertizën dhe shpërndarjen e kohës), në mënyrë që të përfundojë në mënyrë efektive të gjitha aktivitetet e kërkuara sipas termave të referencës dhe për të arritur përfundimisht objektivat specifike dhe të përgjithshme të kontratës për sa i përket kohës, kostos, dhe cilësisë. Për të kryer studimin, do të caktohet një ekip ekspertësh me kualifikimet minimale të mëposhtme. Ekipi i ekspertëve të konsulentëve do të jetë i pranishëm të paktën 85% në terren për fazën fillestare (Inception phase) dhe nuk do të angazhohet në projekte të tjera gjatë zbatimit të këtij projekti, bazuar në grafikun e propozuar nga Konsulenti. Konsulenti duhet të përgatisë Planin e Mobilizimit në përputhje me listën e dorëzimeve. Konsulenti duhet të përshkruajë, në Planin e Mobilizimit (si pjesë e Metodologjisë së Propozuar), përbërjen dhe strukturën e ekipit të tij, listën e ekspertëve, ditët kur këta ekspertë do të angazhohen në këtë projekt, stafin mbështetës, CV-të, diplomat universitare, etj. Konsulenti është i lirë të propozojë cilindo ekip që ai mund ta konsiderojë të përshtatshëm për ofrimin e shërbimeve të kërkuara, përveç pozicioneve "kyçe" të

paraqitura më poshtë. Ekspertët do të jenë subjekt i miratimit nga Autoriteti Kontraktor para fillimit të punës. Termat e Referencës përmbajnë profilet e ekspertëve dhe Konsulenti do të duhet të demonstrojë në ofertën e tij që ata kanë marrëveshje me ekspertët e profileve të kërkuara.

Specialistët e parashikuar dhe kualifikimet e preferuara janë si më poshtë:

Ekspertët kryesorë	Kualifikimet
Drejtues Ekipi / 1 (një) Inxhinier Hidroteknik	<p>Kualifikimet dhe aftësitë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diplomë universitare në Inxhinieri Hidroteknike - Liçencë personale në projektim - Një minimum prej 10 vite përvojë rajonale/ndërkombëtare në një rol drejtues të lartë në projektim/studime në projektet hidroteknike. <p>Përvojë specifike profesionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përvojë në menaxhimin e të paktën nje projekti të përmasave dhe kompleksitetit të ngjashëm në veprat hidroteknike <p>Detyrat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëheqësi i Ekipit do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e përgjithshme teknike dhe administrative të detyrës, koordinimin e ekipit të ekspertëve, planifikimin dhe ecurinë e aktiviteteve, koordinimin me palët e interesuara, menaxhimin financiar, raportimin dhe asistencën e përgjithshme teknike në menaxhimin e projektit.
1 (një) Inxhinier Ndertimi	<p>Kualifikimet dhe aftësitë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diplomë universitare në Inxhinieri Ndërtimi - Liçencë personale në projektim - Përvojë e përgjithshme profesionale: - Të paktën 10 vjet përvojë rajonale/ndërkombëtare në një rol kryesor në projektim/studime për (ri)ndërtimin/rehabilitimin e infrastrukturës kulluese dhe vaditese. <p>Përvojë specifike profesionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Eksperiencë në projektimin e digave, veprave te artit etj... - Përvoja e mëparshme në kontratat e BE-së do të ishte një avantazh; <p>Detyrat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ai/ajo do të jetë përgjegjës për projektimin te strukturave mbajtese.
1 (një) Arkitekt	<p>Kualifikimet dhe aftësitë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diplomë universitare në Arkitekture - Liçencë personale në projektim - Përvojë e përgjithshme profesionale: - Të paktën 10 vjet përvojë rajonale/ndërkombëtare në një rol kryesor në projektim/studime për (ri)ndërtimin/rehabilitimin e peisazheve natyrore pas nderhyrjeve. <p>Përvojë specifike profesionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Eksperiencë në projektimin e digave, veprave te artit etj... - Përvoja e mëparshme në kontratat e BE-së do të ishte një avantazh; <p>Detyrat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ai/ajo do të jetë përgjegjës për Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, etj...
1 (një) Inxhinier Mjedisi	<p>Kualifikimet dhe aftësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diplomë universitare në Inxhinieri Mjedisi - Liçencë personale në projektim <p>Përvojë e përgjithshme profesionale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Minimumi 10 vjet përvojë në zhvillimin e studimeve të vlerësimit të ndikimit mjedisor (VNM) . <p>Përvojë specifike profesionale.</p> <p>Detyrat:</p>

	- Ai/ajo do të jetë përgjegjës për gatitjen e raporteve dhe studimeve mjedisore .
1 (një) Inxhinier Gjeodet Markshajder /Topograf;	<p>Kualifikimet dhe aftësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diplomë universitare në Inxhinieri Gjeodezi/ Markshajder. - Liçencë personale në projektim <p>Përvojë e përgjithshme profesionale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të paktën 10 vjet përvojë rajonale/ndërkombëtare në një rol kryesor në projektim/studime për (ri)ndërtimin/rehabilitimin e infrastrukturës kulluese dhe vaditëse. <p>Detyrat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ai/ajo do të jetë përgjegjës për rilevimin topo gjeodezik të projektit
1 (një) Inxhinier Gjeolog	<p>Kualifikimet dhe aftësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diplomë universitare në Inxhinieri Gjeologji - Liçencë personale në projektim <p>Përvojë e përgjithshme profesionale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të paktën 10 vjet përvojë rajonale/ndërkombëtare në një rol kryesor në projektim/studime për (ri)ndërtimin/rehabilitimin e infrastrukturës kulluese dhe vaditëse. <p>Detyrat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ai/ajo do të jetë përgjegjës për studimin gjeologjik të tojeve
1 (një) Inxhinier Gjeofizik /Sizmiolog;	<p>Kualifikimet dhe aftësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diplomë universitare në Inxhinieri Gjeofizik /Sizmiolog - Liçencë personale në projektim <p>Përvojë e përgjithshme profesionale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të paktën 10 vjet përvojë rajonale/ndërkombëtare në një rol kryesor në projektim/studime për (ri)ndërtimin/rehabilitimin e infrastrukturës kulluese dhe vaditëse. <p>Detyrat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ai/ajo do të jetë përgjegjës për studimin sizmologjik të trojeve
1 (një) Inxhinier Elektrik	<p>Kualifikimet dhe aftësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diplomë universitare në Inxhinieri Elektrike - Liçencë personale në projektim <p>Përvojë e përgjithshme profesionale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të paktën 10 vjet përvojë rajonale/ndërkombëtare në një rol kryesor në projektim <p>Detyrat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ai/ajo do të jetë përgjegjës për projektet elektrike dhe të automatizimit të veprave të komandimit dhe sistemit monitorimit
1 (një) Inxhinier Mekanik	<p>Kualifikimet dhe aftësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diplomë universitare në Inxhinieri Mekanike - Liçencë personale në projektim <p>Përvojë e përgjithshme profesionale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të paktën 10 vjet përvojë rajonale/ndërkombëtare në një rol kryesor në projektim/studime për (ri)ndërtimin/rehabilitimin e infrastrukturës kulluese dhe vaditëse. <p>Detyrat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ai/ajo do të jetë përgjegjës për projektet mekanike, sinjalistike dhe automatizimit të veprave të komandimit
Stafe ndimes	Kualifikimet
2 (dy) Inxhinier Hidroteknik	<p>Kualifikimet dhe aftësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diplomë universitare në Inxhinieri Hidroteknike - Liçencë personale në projektim - CV - Referencë
1 (një) Inxhinier Ndertimi profili strukturist	<p>Kualifikimet dhe aftësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diplomë universitare në Inxhinieri Ndertimi

	<ul style="list-style-type: none"> - Liçencë personale në projektim - CV - Referencë
1 (një) Inxhinier Gjeodet	Kualifikimet dhe aftësitë <ul style="list-style-type: none"> - Diplomë universitare në Inxhinieri Gjeodet - Liçencë personale në projektim - CV - Referencë
1 (një) Inxhinier Gjeoteknik	Kualifikimet dhe aftësitë <ul style="list-style-type: none"> - Diplomë universitare në Inxhinieri Gjeoteknike - Liçencë personale në projektim - CV - Referencë
1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis	Kualifikimet dhe aftësitë <ul style="list-style-type: none"> - Diplomë universitare në Inxhinieri - Të ketë Çertifikatën e ekspertit nga Ministria e Mjedisit; - Përvojë e përgjithshme profesionale - Të paktën përvojë rajonale/ndërkombëtare ne studime të vlerësimit të ndikimit mjedisor (VNM) Detyrat: <ul style="list-style-type: none"> - Ai/ajo do të jetë përgjegjës përgatitjen e VNM-së në kuadër të studim projektim .

6.4.4 Mjetet dhe paisjet

Konsulenti duhet të sigurojë mjetet dhe paisjet e duhur (në lidhje me ekspertizën dhe shpërndarjen e kohës), në mënyrë që të përfundoj në mënyrë efikase të gjitha aktivitetet e kërkuara sipas termave të referencës dhe për të arritur përfundimisht objektivat specifike dhe të përgjithshme të kontratës për sa i përket kohës, kostos, dhe cilësisë si më poshtë:

Mjete dhe paisje	Specifikime
1(një) Pajisje për matjet gjeodezike Total Station/GPS.	profesionale - Të paktën
1(nje) Pajisje për matjet gjeodezike dron.	profesionale - Të paktën
1(nje) automjete transporti	profesionale - Të paktën

7 FONDI LIMIT.

Vlera që është parashikuar nga Bashkia Durrës, për hartimin e projektit me të gjitha fazat është në total rreth 9,921,678.64 lekë pa T.V.SH , referuar V.K.M 354 datë 11.05.2016, për vlerë të projekt – preventivit 129,538,651.89 lekë pa T.V.SH, vlerë kjo e përafërt e nxjerrë nga projekt-preventivat ide me volume të ndryshme të cilat janë perlogaritur nga specialist të fushës.

8 STANDARDET

8.1 Standarde në projektim.

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektimin që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i standardeve dhe normave

përkatëse. Projektuesi duhet të rekomandoj dhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-së, si edhe të praktikave me të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.

8.1.1 Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkua kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, më të avancuara të fushës. Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të kihet parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për Planifikimin e Territorit”, Rregullorja e Urbanistikës dhe Legjislacioni në fuqi. Me anën e këtij raporti teknik të sqarohen investigimet e bëra nga projektuesi për gjendjen ekzistuese, kushtet teknike dhe kriteret e projektimit, llogaritjet përkatëse për mënyrën e furnizimit me ujë, konsumit të energjisë dhe qëndrueshmërisë së digës. Gjithashtu të jepen përshkrime për fazat e ndërhyrjes dhe rehabilitimit të sistemit, specifikimet teknike për materialet si dhe proceset e punimeve që do të kryhen, vizatimet e nënobjekteve, që do të ndërtohen (planimetri, profila, prerje, hollësi ndërtimore, detaje teknike etj) si dhe volumet kryesore të punimeve dhe materialeve, makinerive e pajisjeve që duhen për kryerjen e kësaj ndërhyrjeje për ndërtimin e këtij objekti dhe për zgjidhjen përfundimtare të problemit të furnizimit me ujë, për sot dhe perspektiv.

9 MARRJA NË DORËZIM

Marrja në dorëzim e dokumentacionit të shërbimit (raporte, projekte etj.) do të bëhet nga specialistë të Bashkis Durrës. Për këtë qëllim, firma konsulente duhet të marrë kontakte në lidhje me disponibilitetin e materialeve që do ti nevojiten.

GRUPI I PUNËS

1. Ing.Lorenc FACJA
2. Ing. Robert Dervishi
3. Ark. Bianka Madhi